



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

---

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/10 qershor 2016), Auditori i Përgjithshëm miraton:

**RREGULLORE (ZKA) NR. 03/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE  
PLOTËSIMIN E RREGULLORES (ZKA) NR. 03/2024 PËR  
KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN KOMBËTARE TË  
AUDITIMIT**

---

<sup>1</sup> Rregullore ZKA Nr. 03/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKA) Për Klasifikimin e Vendeve të Punës, e nënshkruar nga Auditorja e Përgjithshme me datë: 27.11.2025, me Vendim Nr.2188 /2025.

## **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (ZKA) nr. 03/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

## **Neni 2**

1. Në nenin 7, paragrafi 3, të Rregullores bazike, pas fjalës “ e performancës ” fshihet pjesa “ dhe të prokurimit ”.

2. Neni 7, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3.3. Certifikimi: Certifikatë për auditim të jashtëm ose auditor i certifikuar i sektorit publik, apo certifikim për auditim të performancës.

## **Neni 3**

Neni 17, titulli i nenit ndryshohet si vijon “Udhëheqës i Njësisë për Çështje Juridike”.

## **Neni 4**

Neni 23, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3.3.Certifikimi: Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik, apo certifikim ndërkombëtar apo vendor në fushën e auditimit të performancës.

## **Neni 5**

Neni 25 i Rregullores bazike fshihet.

## **Neni 6**

1. Neni 27, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

2.2. Përvoja profesionale: pesë (5) vjet përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre 3 vjet në auditim të jashtëm si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e tre (3) auditimeve të jashtme.

2. Neni 27, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3.2. Përvoja profesionale: pesë (5) vjet përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku tre (3) vjet në auditim të performancës apo të pajtueshmërisë, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve të performancës apo 2 auditimeve të pajtueshmërisë.

3. Neni 27, paragrafi 4 i Rregullores bazike fshihet.

### **Neni 7**

1. Neni 28, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 ndryshohet si vijon:

2.2. Përvoja profesionale: Katër (4) vjet përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë, prej tyre së paku një (1) vjet në auditim të jashtëm.

2 Neni 28, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ndryshohen si vijon:

3.2. Përvoja profesionale: Katër (4) vjet përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre një (1) vjet në auditimin e performancës apo të pajtueshmërisë;

3.3. Certifikim: Certifikatë për kontabilist ose Certifikatë për auditor të sektorit publik, certifikatë ndërkombëtare apo vendore në fushën e auditimit të performancës.

3. Neni 28, paragrafi 4 i Rregullores bazike fshihet.

### **Neni 8**

Pas nenit 28 të Rregullores bazike, shtohen dy nene të reja 28A dhe 29A:

### **Neni 28A**

#### **Auditor i Lartë i Teknologjisë së Informacionit**

1. Kërkesat e përgjithshme formale për pozitën e punës Auditor i Lartë i Teknologjisë së Informacionit janë:

1.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, inxhinieri, shkenca kompjuterike apo sisteme të informacionit;

1.2. Përvoja profesionale: Pesë (5) vjet përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, prej tyre së paku tre (3) vjet në fushën e auditimit, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve;

1.3. Certifikimi: certifikatë për auditor nga fusha e TI-së;

1.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

2. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B6.

**Neni 29A**  
**Auditor i Teknologjisë së Informacionit**

1. Kërkesat e përgjithshme formale për pozitën e punës Auditor i Teknologjisë së Informacionit janë:

1.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, inxhinieri, shkenca kompjuterike apo sisteme të informacionit;

1.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vjet përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, preferohet përvojë pune në fushën e auditimit;

1.3. Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;

1.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

2. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z1.

**Neni 9**

Neni 35, titulli i nenit ndryshohet si vijon “Këshilltar i lartë Juridik”.

**Neni 10**

Neni 36, titulli i nenit ndryshohet si vijon “Këshilltar Juridik”

**Neni 11**

Pas nenit 36 të Rregullores bazike shtohet një nen i ri 36A si në vijim:

**36 A**  
**Zyrtar i Lartë Ligjor**

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë të fakultetit juridik;

2.2. Përvoja profesionale: Një (1) vjet përvojë pune profesionale në çështje juridike apo administratë.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

## **Neni 12**

Neni 38, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore, gazetari ose komunikim masiv.

## **Neni 13**

Neni 41, paragrafi 3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6

## **Neni 14**

Neni 43, paragrafi 3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6

## **Neni 15**

Pas nenit 43 të Rregullores bazike shtohet një nen i ri 43A si në vijim:

### **43 A**

#### **Zyrtar për pranim të mallit dhe shërbimeve**

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës:

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi,

2.2. Përvoja profesionale: Një (1) vjet përvojë pune profesionale në administratë, buxhet dhe financa.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X7.

## **Neni 16**

Neni 45, paragrafi 3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6

## **Neni 17**

Neni 51, paragrafi 3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X9

### **Neni 18**

Neni 52, paragrafi 3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X9

### **Neni 19**

#### **Dispozita Kalimtare**

1. Personelit sipas klasifikimit paraprak të vendeve të punës, iu zëvendësohen, plotësohen dhe harmonizohen aktet individuale të marrëdhënies së punës, në përputhje me ndryshimet sipas kësaj Rregulloreje.

2. Përgatitja e përshkrimit të detyrave të punës për pozitat e reja dhe përditësimi për pozitat ekzistuese, koordinohet nga Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me njësitë tjera organizative, jo më larg se nëntëdhjetë (90) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje. Auditori i Përgjithshëm miraton të gjitha përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësitë e punës.

3. Numri i stafit auditues në Zyrën Kombëtar të Auditimit është njëqind e tridhjetë e katër (134).

4. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca një (I), me ndryshime.

5. Ndryshimet në koeficient për pozitat sipas kësaj Rregulloreje do të zbatohen në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit, respektivisht prej janarit 2026.

### **Neni 20**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Vlora SPANCA**

---

**Auditore e Përgjithshme**

## SHTOJCA I- Klasifikimi i pozitave sipas kategorisë dhe numrit të të punësuarve në ZKA

<b>Pozicioni /Struktura</b>	<b>Kategoria</b>	<b>Numri</b>
1. Auditor i Përgjithshëm;	/	1
1.2. Udhëheqës i Kabinetit	Nëpunës Kabineti	1
1.3. Zyrtar Ekzekutiv	Nëpunës Kabineti	1
1.4. Asistent Ekzekutiv	Nëpunës Kabineti	1
1.5. Vozitësi	Nëpunës Kabineti	1
1.6. Këshilltar	Nëpunës Kabineti	1
<b>Totali i të punësuarve është</b>		<b>6</b>
2. Zëvendës Auditor i Përgjithshëm	Drejtues i lartë	1
3. Ndihmës Auditor i Përgjithshëm	Drejtues i lartë	5
4. Drejtor i Përgjithshëm	Drejtues i lartë	1
4.1. Zyrtar i lartë ligjor	Profesional	1
5. Drejtor i Departamentit të Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë	Drejtues i mesëm 1	
5.1. Auditor Senior	Profesional	
5.2. Auditor	Profesional	

5.3. Auditor Junior	Profesional	
5.4. Ekspert i Auditorit në Fushën e Ndërtimtarisë	Profesional	
6. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës	Drejtues i mesëm 1	
6.1. Auditor Senior i Performancës	Profesional	
6.2. Auditor i Performancës	Profesional	
6.3. Auditor Junior i Performancës	Profesional	
7. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit	Drejtues i mesëm 1	
7.1. Auditor i Lartë i Teknologjisë së Informacionit	Profesional	
7.2. Auditor i Teknologjisë së Informacionit	Profesional	
8. Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza	Drejtues i mesëm 1	
8.1. Auditor Specialist për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza	Profesional	
8.2. Analist për Planifikim dhe Raportim	Profesional	
9. Drejtor i Departamentit për Metodologji në Auditim	Drejtues i mesëm 1	

9.1. Auditor Specialist për Metodologji	Profesional	
10. Drejtor i Departamentit për Sigurimin e Cilësisë në Auditim	Drejtues i mesëm 1	
10.1. Auditor Specialist për Sigurimin e Cilësisë	Profesional	
<b>Totali i të punësuarve në këto Departamente është</b>		<b>134</b>
11. Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve	Drejtues i mesëm 1	1
11.1. Udhëheqës i Njësisë Kundër Mashtrimeve	Drejtues i ultë 1	1
11.1.1. Këshilltar i Lartë Kundër Mashtrimeve	Profesional	2
11.2. Udhëheqës i Njësisë për Çështje Juridike	Drejtues i ultë 1	1
11.2.1. Këshilltar i Lartë Juridik	Profesional	3
11.2.2. Këshilltar Juridik	Profesional	1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Departament është</b>		<b>9</b>
12. Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim	Drejtues i mesëm 1	1
12.1. Zyrtar për Bashkëpunim	Profesional	1
12.2. Zyrtar për Komunikim me Publikun	Profesional	2
12.3. Zyrtar për Dizajn dhe Grafikë të Publikimeve	Profesional	1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Departament është</b>		<b>5</b>
13. Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Drejtues i mesëm 2	1

13.1. Zyrtar për Burime Njerëzore	Profesional	1
13.2. Zyrtar për Zhvillim Profesional	Profesional	1
13.3. Zyrtar për Administrim të Dokumenteve	Profesional	1
<b>Totali i të punësuarve</b>		<b>4</b>
14. Drejtor i Departamentit për Buxhet, Financa dhe Raportim	Drejtues i mesëm 2	1
14.1. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	Drejtues i ultë 2	1
14.2. Zyrtar i lartë për Buxhet dhe Financa	Profesional	1
14.3. Zyrtar për Buxhet dhe Financa	Profesional	1
14.4. Zyrtar për pranim të mallit dhe shërbimeve	Profesional	1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Departament është</b>		<b>5</b>
15. Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përbashkëta	Drejtues i mesëm 2	1
15.1. Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë	Drejtues i ultë 2	1
15.1.1 Zyrtar për Logjistikë	Profesional	1
15.1.2. Vozitës	Mbështetës	3
15.1.3. Mirëmbajtës i Objektit dhe Shërbimeve Postare	Mbështetës	1
15.2. Udhëheqës i Divizionit për Përkthim dhe Lekturë	Drejtues i ultë 2	1
15.2.1. Lektor	Profesional	1
15.2.2. Përkthyes	Profesional	3
15.3. Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumentacionit	Drejtues i ultë 2	1

15.3.1. Zyrtar për Regjistrim dhe Ruajtje të Materialit Arkivor	Profesional	1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Departament është</b>		<b>14</b>
16. Drejtor i Departamentit për Teknologji të Informacionit	Drejtuës i mesëm 1	1
16.1. Administrator i Sistemit	Profesional	1
16.2. Administrator i Bazave të të Dhënave	Profesional	1
16.3. Specialist i Teknologjisë së Informacionit për Rrjet dhe Harduer		1
16.4. Specialist i Mbështetjes për Sisteme		1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Departament është</b>		<b>5</b>
17. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm	Drejtuës i mesëm 2	1
17.1. Auditor i Brendshëm	Profesional 1	1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Departament është</b>		<b>2</b>
18. Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit	Drejtuës i mesëm 2	1
18.1. Zyrtar për Prokurim	Profesional	1
<b>Totali i të punësuarve në këtë Njësi është</b>		<b>2</b>
<b>Totali i të punësuarve në ZKA është</b>		<b>194</b>